



Periodik mujor

Nr. 167

Prill 2023

**Në
këtë
periodik
do të lexoni:**

**Miratohet “Strategjia e Autoritetit të
Mbikëqyrjes Financiare 2023-2027”**

03

**VËSHTRIM
MBI TREGJET**

Tregu i Sigurimeve, Janar- Mars 2023

04

ZHVILLIME TË TJERA

**BOTIME
PROFESIONALE**

05-14

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

15-18

Miratohet “Strategjia e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, 2023-2027”



Bordi i AMF miratoi me Vendimin nr. 34, datë 31.03.2023 “Strategjinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare 2023-2027”. Ky dokument hartohet në vijim të dokumentit strategjik të AMF-së 2018-2022 dhe paraqet vizionin e Autoritetit për zhvillime të qëndrueshme dhe të sigurta në tregjet nën mbikëqyrje.

Strategjia 2023-2027, përcakton disa prioritetë të rëndësishme për zhvillim, për periudhën afatmesme dhe është strukturuar sipas drejtimeve të mëposhtme:

- Forcimi i stabilitetit financiar, rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve;
- Përafrimi i legjislacionit me standardet evropiane, zhvillimi dhe modernizimi i tregjeve;
- Mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit;
- Zhvillimi i financimit të gjelbër dhe harmonizimi me praktikën evropiane;
- Digjitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Autoriteti synon promovimin dhe nxitjen e standardeve të larta për mbrojtjen e konsumatorëve dhe integritetin e të licencuarve, garantimin e stabilitetit të tregut financiar jobankar, si dhe përmirësimin e shkallës së profesionalizmit, nëpërmjet forcimit të vazhdueshëm të rregullimit dhe mbikëqyrjes të tregjeve. Vizioni i Autoritetit është të kontribuojë drejt përafrimit legjislativ dhe rregullator me Bashkimin Evropian, për forcimin e standardeve të tregjeve nën mbikëqyrje, si dhe të lehtësojë ndërlidhjen e tregjeve vendase me ato ndërkombëtare.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar – Mars 2023


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-mars 2023 kapën vlerën 5,142 milionë lekë, ose 20.12% më shumë se në janar-mars 2022. Gjatë periudhës janar-mars 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 285,282 me një rritje prej 15.23% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.88% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, sigurimet e Jetës kanë 8.09% dhe risigurimi 0.028%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 46.58% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 53.42% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-mars 2023, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 1,611 milionë lekë, ose 10.10% më shumë se në muajin janar-mars 2022.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin e motorik për periudhës janar-mars 2023 kapën vlerën 1,155 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 15.16% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Mars 2023 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-mars 2023 arritën rreth 2,747 milionë lekë, ose 9.83% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2022

ZHVILLIME TË TJERA

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së në Forumin e Klimës së Biznesit

AMF ka ndërmarrë një harmonizim të kuadrit ligjor e rregullator në tregjet e kapitalit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive me direktivat evropiane, proces i vlerësuar nga Komisioni Evropian në Raportet e Progresit.



Tiranë, 25 prill 2023 - Forumi i Klimës së Biznesit 2023, "Sfidat e rritjes dhe produktiviteti"

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete, mori pjesë në sesionin e parë të Forumit të Klimës së Biznesit 2023, "Sfidat e rritjes dhe produktiviteti", ku u diskutua mbi faktorët kryesorë të nxitjes së rritjes dhe produktivitetit në vend, përfshirë aksesin në financim dhe rolin e sektorit financiar në këtë drejtim, për të rritur konvergencën me vendet e Bashkimit Evropian.

Z. Mete u shpreh se zgjerimi i aksesit në financë dhe alokimi eficient i kapitalit është faktor shumë i rëndësishëm për rritjen dhe produktivitetin. Diversifikimi i sistemit financiar, përmes zgjerimit të tregjeve të kapitalit, krijon më shumë mundësi dhe ofron më tepër likuiditet për sipërmarrjet, duke kontribuar në rritjen e produktivitetit, si dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

AMF ka ndërmarrë një harmonizim të kuadrit ligjor e rregullator në tregjet e kapitalit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive me direktivat evropiane, proces i vlerësuar nga Komisioni Evropian në Raportet e Progresit. Në linjë me rregullimet evropiane, aktet e reja kanë diversifikuar shërbimet e investimit, si edhe kanë zgjeruar mundësitë e ndërlidhjes me tregjet ndërkombëtare.

Panelistë të sesionit të parë ishin z. Emanuel Salinas, Menaxher i Bankës Botërore për Shqipërinë, Znj. Majlinda Dhuka, Ministër Shteti dhe Kryenegociator, znj. Sonja Kurz, Drejtuese e GIZ Shqipëri, si edhe përfaqësues të bizneseve dhe dhomave të tregtisë.

AMF bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe atë të Arsimit për Strategjinë Kombëtare të Edukimit dhe Përfshirjes Financiare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në funksion të Strategjisë Kombëtare të Edukimit dhe Përfshirjes Financiare. Më 20 prill 2023 u zhvillua mbledhja e parë e Komitetit Drejtues të Strategjisë, ku Autoriteti u përfaqësua nga zj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtorë Ekzekutive.

Në këtë takim u diskutua mbi rëndësinë e edukimit dhe përfshirjes financiare në Shqipëri, veprimet e ndërmarra, si dhe modalitetet për përcaktimin e një kuadri të qartë ndërinstitucional bashkëpunimi për zhvillimin dhe implementimin e aktiviteteve të përbashkëta në funksion të Strategjisë Kombëtare të Edukimit dhe Përfshirjes Financiare.

Nëndrejtorja Ekzekutive e AMF theksoi se Autoriteti ndër vite ka ndërmarrë një sërë nismash për edukimin financiar dhe do të vijojë aktivitetet edukuese për rritjen e njohurive financiare për tregjet nën mbikëqyrje, si një ndër prioritetet e përcaktuara edhe në Strategjinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare 2023-2027.

“Edukimi financiar dhe rritja e besimit në tregjet financiare mbështesin përfshirjen financiare të qytetarëve dhe kontribuojnë në rritjen e aksesit në financë. Institucionalizimi dhe koordinimi i të gjitha institucioneve me rol kyç përmes këtij Komiteti Drejtues, përbën një hap të rëndësishëm në bashkëpunimin mes Autoritetit, Bankës së Shqipërisë dhe ministrive, në funksion të nismave të përbashkëta për rritjen e edukimit dhe përfshirjes financiare në vendin tonë,” u shpreh zj. Mimoza Kaçi.

Zhvillimi dhe implementimi i Strategjisë Kombëtare të Edukimit dhe Përfshirjes Financiare synohet të realizohet përmes një strukture ndërinstitucionale, Komitetit Drejtues të Strategjisë, me përfaqësues të lartë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, i cili do të mbikëqyrë zbatimin e strategjisë. Gjithashtu do të krijohen Komitetet e Ekspertëve dhe Grupet institucionale të punës për hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve të edukimit.

—○○○—
Edukimi financiar dhe rritja e besimit në tregjet financiare mbështesin përfshirjen financiare të qytetarëve dhe kontribuojnë në rritjen e aksesit në financë.
—○○○—

Miratohet Dokumenti Politik “Për Krijimin e një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Shqipëri, 2023-2027”



Objektivi i përgjithshëm është promovimi i tregjeve eficiente të kapitalit nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të këtyre tregjeve dhe mbikëqyrjes efektive të tyre.

Këshilli i Ministrave ka miratuar Dokumentin Politik “Për Krijimin e një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Shqipëri, 2023-2027”, i hartuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Dokumenti analizon situatën e tregut të kapitaleve në Shqipëri dhe infrastrukturën e tij, duke propozuar ndërmarrjen e planeve konkrete të veprimit për zhvillimin e tregut të kapitaleve përgjatë një periudhe 5-vjeçare.

Objektivi i përgjithshëm është promovimi i tregjeve eficiente të kapitalit nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të këtyre tregjeve dhe mbikëqyrjes efektive të tyre. Për arritjen e këtij objekti, Dokumenti Politik merr në konsideratë një sërë faktorësh, si: përcaktimi i kushteve paraprake të zhvillimit të tregut, adresimi i sfidave dhe problematikave, identifikimi i prioriteteve për zhvillimin e tregut të kapitaleve, bashkëpunimi mes institucioneve me rol kyç për zhvillimin e këtij tregu, sigurimi i mbikëqyrjes efektive, si edhe përcaktimi i planeve të veprimit sipas prioriteteve të vendosura.

Objektivat kryesorë strategjikë të dokumentit janë: rritja e pjesëmarrjes së emetuesve, zgjerimi i bazës së investitorit dhe zgjerimi i gamës së instrumenteve financiare, eficientia dhe transparenca e tregut të kapitaleve, si edhe zhvillimi i tregut sekondar të Titujve të Qeverisë. Bazuar në këto objektiva, në dokument parashikohen masa dhe veprime konkrete për arritjen e tyre.

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në zbatim të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 "Për Tregjet e Kapitalit", ka hartuar me asistencë të huaj dhe mbështetje të Bankës Botërore projektregulloren për "Licencimin dhe funksionimin e platformës shumëpalëshe të tregtimit (PSHT), platformës së organizuar të tregtimit (POT) dhe kërkesat për shoqëritë komisionere që veprojnë si internalizues sistematikë", e cila është përafuar me një sërë direktivash dhe rregulloresh të Bashkimit Evropian në fushën e tregjeve të kapitalit.

Projektregullorja publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=89>


Kjo projektregullore, krahas tregut të rregulluar apo Bursës, prezanton një kategori të re platformash tregtimi për listimin dhe tregtimin e instrumenteve financiare, sikurse janë Platforma Shumëpalëshe e Tregtimit (PSHT) dhe Platforma e Organizuar e Tregtimit (POT), të njohura në legjislacionin evropian përkatësisht si platformat MTF (*Multilateral Trading Facilities*) dhe OTF (*Organized Trading Facilities*).

Projektregullorja përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat dhe procedurat për dhënien e licencës për të operuar një Platformë Shumëpalëshe Tregtimi apo një Platformë të Organizuar Tregtimi si dhe për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këtyre platformave.

Dokumenti i publikuar për konsultim publik kërkon plotësimin e disa kërkesave nga ana e operatorëve të tregut përpara operimit të këtyre platformave, si një sistem efikas tregtimi; masa për administrimin e rrezikut; të dhëna për anëtarët dhe përdoruesit e mundshëm të sistemit; llojin e instrumenteve financiare që mund të tregtohen brenda sistemit, masat për të mundësuar finalizimin efikas dhe në kohë të transaksioneve të kryera në sistem si dhe burime të mjaftueshme financiare për sigurimin e kësaj veprimtarie.

Projektregullorja gjendet në linkun <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=89>

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloret për tregun e kapitaleve, të përafruara me direktivat evropiane



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në zbatim të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 "Për Tregjet e Kapitalit" ka hartuar disa projektregullore, të cilat i publikon për konsultim publik.

- [Projektregullorja “Për kriteret e licencimit dhe funksionimit të bursave dhe operatorëve të tregut që vënë në funksion veprimtarinë e një tregu të rregulluar”;](#)
- [Projektregullorja “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit qendror të titujve”;](#)
- [Projektregullorja “Për kërkesat e licencimit dhe të funksionimit të shtëpisë së klerimit dhe kundërpalës qendrore”;](#)
- [Projektregullorja “Për kriteret dhe kërkesat e miratimit të shoqërisë audituese të shoqërisë komisionere dhe institucioneve të tregut”.](#)

Këto projektregullore janë përafruar gjerësisht me legjislacionin dhe direktivat evropiane në tregjet e kapitalit.

Projektregullorja “Për kriteret e licencimit dhe funksionimit të bursave dhe operatorëve të tregut që vënë në funksion veprimtarinë e një tregu të rregulluar” është hartuar në linjë me Direktivën dhe rregulloren MIFID II/MIFIR si dhe standardet teknike rregullatore të Autoritetit Evropian të Titujve dhe Tregjeve (ESMA). Gjithashtu, projektregullorja “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit qendror të titujve” realizon një përafrim në nivel më të lartë me rregulloren e Bashkimit Evropian për depozitarin qendror të titujve. Projektregullorja “Për kërkesat e licencimit dhe të funksionimit të shtëpisë së klerimit dhe kundërpalës qendrore”, rregullon për herë të parë veprimtarinë e një kundërpale qendrore, e njohur si CCP, e cila merr sidomos rëndësi të veçantë në rastin e klerimit/shlyerjes së produkteve derivative.

Në kuptim të ligjit për tregjet e kapitalit, bursa, depozitari qendror i titujve si dhe shtëpitë e klerimit apo kundërpala qendrore (CCP) konsiderohen institucione tregu, për të cilat projektregullorja “Për kriteret dhe kërkesat e miratimit të shoqërisë audituese të shoqërisë komisionere dhe institucioneve të tregut” vendos kritere për përzgjedhjen dhe miratimin e shoqërisë audituese të këtyre institucioneve.

Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare” (Journal of Risk Management in Financial Institutions)

Vëllimi 16, 2023, Numri 2 henrystewartpublications.com

Ky numër përmban ndër të tjera edhe artikujt e mëposhtëm:


Punime praktike

- “Çmimi i rreziqeve të tranzicionit klimatik në tregje të ndryshme financiare” - Dirk Broeders, Menaxher i Lartë i Riskut Financiar, Bernd Schouten, Ekonomist, Isabelle Tiems, Ekonomist dhe Niek Verhoeven, Ekonomist, De Nederlandsche Bank
- “Ndikimi i rrezikut të klimës në industrinë e sigurimeve: Zhvillimet e fundit dhe qasjet e reja për zbutjen e rrezikut” - Sonjai Kumar, anëtare e certifikuar e Institutit të Menaxhimit të Riskut dhe Purnima Rao, Profesor i Asociuar, Instituti Fortune i Biznesit Ndërkombëtar
- “Ndikimi marginal i skenarëve të parashikuar të rrezikut klimatik në testet e stresit të portofolit të rrezikut të kredisë” - Jonas de Oliveira Campino, specialist kryesor i menaxhimit të rrezikut strategjik, Banka Ndër-Amerikane e Zhvillimit
- “Qasje për përcaktimin sasior të ndikimeve financiare të dëmtimit të reputacionit nga ndryshimet klimatike” - Michael Grimwade, Drejtor Menaxhues, Risku Operacional, ICBC Standard Bank Plc

Punime kërkimore

- “Integrimi i informacionit lidhur me faktorët ESG në optimizimin e portofolet” - Haoming Cao, student i diplomës Master i Matematikës dhe Tony S. Wirjanto, Profesor, Universiteti i Waterloo
- “Vlerësimi i Vlerës në Rrezik (*Values-at-Risk*) duke përdorur një qasje joparametrike” - Amir Olfat, PhD Student i Statistikës dhe Farzad Eskandari, Profesor i Statistikës, Universiteti Allameh Tabataba'i
- “Vlerësimi i Vlerës në Rrezik (*Values-at-Risk*) dhe mungesës së pritshme të produkteve metalike: Zbatimi i metodës GARCH-EVT” - Maaz Khan, Universiteti COMSATS Islamabad; Mrestyal Khan, Lektor dhe Muhammad Irfan, Profesor i Asociuar dhe Zëvendës Dekan, Universiteti Balochistan i Teknologjisë së Informacionit, Inxhinierisë dhe Shkencave të Menaxhimit

... vijon



Volume 16 (2023)

Each volume of *Journal of Risk Management in Financial Institutions* consists of four quarterly 100-page issues. Articles scheduled for Volume 16 are available to view on the '[Forthcoming content](#)' page.

The papers and case studies included in Volume 16 are listed below:

[Volume 16 Number 2](#)

Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare” *(Journal of Risk Management in Financial Institutions)* Vëllimi 16, 2023, Numri 2 [henrystewartpublications.com](https://www.henrystewartpublications.com/jrm/v16)

... Vijon

“Ndikimi i rrezikut të klimës në industrinë e sigurimeve: Zhvillimet e fundit dhe qasjet e reja për zbutjen e rrezikut”

Sonjai Kumar, anëtare e certifikuar e Institutit të Menaxhimit të Riskut dhe Purnima Rao, Profesor i Asociuar, Instituti Fortune i Biznesit Ndërkombëtar

Abstrakt

Punimi diskuton rreziqet kryesore që shfaqen në industrinë e sigurimeve për shkak të përkeqësimit të klimës globale. Së pari, punimi identifikon ndikimet negative që kanë ndodhur në të kaluarën e afërt në industrinë e sigurimeve. Më tej, ai diskuton mjetet e ndryshme që industrinë përdorin për të menaxhuar rreziqet e tyre, të tilla si nënshkrimi (underwriting), menaxhimi i rrezikut dhe zbulimet publike. Së fundi, diskutohen disa masa kyçe të marra nga industria që përfshijnë mos sigurimin e industrive ndotëse, masat shtrënguese për menaxhimin e rrezikut dhe deklaratimet e detyrueshme të rekomanduara nga rregullatorë të ndryshëm të sigurimeve.

Fjalë kyçe: rrezik klimatik; industria e sigurimeve; menaxhimi i rrezikut; zbulimi.

Revista “Menaxhimi i Riskut në
Institucionet Financiare”

*(Journal of Risk Management in
Financial Institutions)*

Vëllimi 16, (2023) Numri 2

<https://www.henrystewartpublications.com/jrm/v16>



IOSCO publikon Programin e Punës për 2023-2024

Bordi i Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) publikoi Programin e Punës 2023-2024 për të çuar më tej objektivat e tij thelbësorë për mbrojtjen e investitorëve, ruajtjen e tregjeve të drejta, efikase e transparente dhe adresimin e rreziqeve sistematike. Programi i punës, si edhe më parë, mbulon një horizont dyvjeçar dhe do të rishikohet dhe rifreskohet, sipas rastit, në fund të 2023 për të siguruar rëndësinë e tij të vazhdueshme.

Jean-Paul Servais, Kryetar i Bordit të IOSCO-s, tha: “Kam kënaqësinë të prezantoj, si kryetar i Bordit të IOSCO-s, planin e punës 2023-2024 të kësaj organizate. Në këtë periudhë, IOSCO do të ofrojë, ndër të tjera, prioritetet e saj për të adresuar rreziqet e reja që rrjedhin nga financimi i qëndrueshëm dhe digjital. Në vitin 2023, IOSCO do të shqyrtojë grupin e parë të standardeve të zhvilluara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Qëndrueshmërisë SNRF (ISSB) për të përcaktuar nëse ato mund të miratohen si një kornizë globale për dhënien e informacioneve shpjeguese të korporatave lidhur me qëndrueshmërinë. IOSCO gjithashtu do të ecë me ritëm me punën e saj të fokusuar te politika në tregjet dhe aktivitetet e krypto-aseteve. Prioritetet e IOSCO-s vazhdojnë të përfshijnë forcimin e qëndrueshmërisë financiare, duke adresuar dobësitë e identifikuara në sektorin e Ndërmjetësimit Financiar Jobankar, së bashku me FSB-në. IOSCO gjithashtu do të vazhdojë të monitorojë zhvillimet e fundit të tregut nga këndvështrimi i mbrojtjes së investitorëve, tregjeve të rregullta dhe stabilitetit financiar në tregjet financiare.”

Martin Moloney, Sekretari i Përgjithshëm i IOSCO-s, tha: “Ne gjithashtu do ta kthejmë vëmendjen tonë në rritjen e nivelit të mbështetjes që u ofrojmë rregullatorëve në mbarë botën për të inkurajuar dhe mbështetur standarde të forta të mbikëqyrjes së letrave me vlerë. Ky plan ambicioz i punës, me afate të ngushta dorëzimi, kërkon shumë nga anëtarët tanë të cilët vazhdojnë të ofrojnë burime të konsiderueshme për të kryer gjithë këtë punë. Rritja e bashkëpunimit me organizma të tjerë ndërkombëtarë është gjithashtu një tipar i fortë i ambicieve tona.”

Vijon ...

IOSCO publikon Programin e Punës për 2023-2024

... Vijon

Programi i punës 2023-2024 bazohet në prioritetet e vazhdueshme të identifikuar më parë, planet e brendshme të punës së Grupit të Angazhimit të Stabilitetit Financiar në nivel Bordi (FSEG) dhe Grupeve të Punës të Bordit, iniciativat sektoriale të përzgjedhura të Komiteteve të Bordit të IOSCO-s, si dhe rrjedhat e reja të punës për të dalë nga diskutimet e Bordit mbi prioritizimin e punës së IOSCO-s.

Programi i punës organizohet në pesë temat e mëposhtme:

- Forcimi i qëndrueshmërisë financiare;
- Mbështetja e efektivitetit të tregut;
- Mbrojtja e investitorëve;
- Adresimi i rreziqeve të reja në qëndrueshmëri dhe Fintech;
- Promovimi i bashkëpunimit rregullator dhe efektivitetit.

Nën temën e **Forcimit të Qëndrueshmërisë Financiare** IOSCO do të ruajë vendosmërinë e saj për të forcuar qëndrueshmërinë e tregjeve globale të kapitalit si një fushë thelbësore e fokusit. Në një kohë presionesh inflacioniste, shqetësimeve recesionare dhe shtrëngimit monetar, IOSCO do të përmbushë angazhimet e saj në kuadër të planit të punës të Ndërmjetësimit Financiar Jobankar (NBFI) të Bordit të Stabilitetit Financiar (FSB) 2023, si pjesë e punës pasuese të rënë dakord në përgjigje ndaj pandemisë COVID -19.

Bordi i IOSCO-s identifikoi **Financat Private** si një prioritet të ri për Programin e Punës 2023-2024. Interesi i ripërtërirë rregullator në këtë fushë rrjedh nga rritja e paprecedentë e financave private dhe roli i saj në rritje në financimin e ekonomisë reale, kombinuar me shqetësimet e shfaqura rreth ndërlydhjes në rritje të sektorit me tregjet publike të rregulluara në një kohë të rrezikut të rritur të normës së interesit në të gjithë botën.

IOSCO do të përqendrohet gjithashtu në **Mbështetjen e Efektivitetit të Tregut dhe Mbrojtjen e Investitorëve**. Ndryshimet e fundit në peizazhin ekonomik kanë krijuar sfida të reja për pjesëmarrësit e tregut dhe kanë nënvizuar rëndësinë e mbajtjes së infrastrukturës së fortë të tregut për të mbështetur aktivitetet elastike të emetimit primar dhe tregtimit sekondar në të gjithë gamën e aktiveve të tregtueshme. Mbetet gjithashtu thelbësore të monitorohet dhe trajtohet keqsjellja dhe të promovohet mbrojtja e investitorëve dhe iniciativat edukuese.

Vijon ...

Informacioni i plotë gjendet
në:
[https://www.iosco.org/news/
/pdf/IOSCONEWS688.pdf](https://www.iosco.org/news/pdf/IOSCONEWS688.pdf)

IOSCO publikon Programin e Punës për 2023-2024

... vijon

Lidhur me **Adresimin e Rreziqeve të reja në Qëndrueshmëri dhe Fintech**, programi i punës i kërkon IOSCO-s të vazhdojë përpjekjet e saj për të kontribuar për përmirësimin e plotësisë, konsistencës dhe krahasueshmërisë së raportimit të qëndrueshmërisë nën drejtimin e Task Forcës së saj të Qëndrueshmërisë. Në mënyrë të ngjashme, në lidhje me Fintech, Programi i Punës kërkon të ruhet momenti i arritur sipas udhërrëfyesit të krypto-aseteve të hartuar në korrik 2022, për të vlerësuar dhe për t'iu përgjigjur rreziqeve që lidhen me aktivitetet e tregut të krypto-aseteve dhe financat e decentralizuara.

IOSCO do të vazhdojë gjithashtu përpjekjet e saj për **Promovimin e Bashkëpunimit Rregullator dhe Eektivitetit**, gjë që është thelbësore në përpjekjet e IOSCO-s për të mbajtur tregje të fuqishme dhe elastike të kapitalit në mbarë botën. Një nga iniciativat kryesore drejt promovimit të bashkëpunimit rregullator është Memorandumi Shumëpalësh i Mirëkuptimit i IOSCO-s (MMoU). IOSCO mbetet e përkushtuar për të promovuar përfitimet e Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit dhe për të inkurajuar më shumë juridiksione që të bëhen nënshkruese të tij.

IOSCO gjithashtu do të vazhdojë punën e saj në fusha të tjera të rëndësishme, duke përfshirë çështjet me rëndësi të veçantë për rritjen dhe tregjet në zhvillim (GEM), bashkëpunimin e saj me FSB-në dhe organet e përcaktimit të standardeve dhe punën e vazhdueshme për monitorimin e zbatimit, ndërtimin e kapaciteteve për anëtarët e saj si edhe mbështetjen dhe edukimin e investitorëve, si një shtyllë kritike e mbrojtjes së tyre.

BULLGARI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të tregut nga Komisioni Bullgar i Mbikëqyrjes Financiare (FSC), tregu bullgar i sigurimeve e mbylli vitin 2022 me një vëllim total të primeve të shkruara bruto prej 3.61 miliardë BGN ose 1.85 miliardë euro, duke u rritur me 10.87% krahasuar me një vit më parë. Duke parë dinamikën e linjave të biznesit, 82.69% e primeve të shkruara bruto janë realizuar në klasat e sigurimeve të Jo-Jetës, rreth 1.53 miliardë euro, ose rreth 12.69% më shumë se në vitin 2021. Ndërsa sigurimet e Jetës realizuan 17.31% të totalit të primeve të shkruara bruto, me vlerë prej 319.76 milionë euro, duke u rritur me 2.95% krahasuar me një vit më parë.

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas statistikave të publikuara nga Banka Kombëtare e Hungarisë, për vitin 2022, tregu i sigurimeve në vende arriti në fund të vitit të kaluar rreth 1,428 miliardë HUF, ose rreth 3.56 miliardë euro), duke u rritur me 7.39% krahasuar me një vit më parë. Vëllimi i primeve të shkruara bruto për segmentin e sigurimit të Jetës u rrit me 1.02% në vit duke arritur në 609 miliardë HUF ose rreth 1.52 miliardë euro. Edhe portofoli i sigurimit të Jo-Jetës u rrit me 12.68% krahasuar e vitin e kaluar duke arritur në 819 miliardë HUF ose 2.04 miliardë euro. Gjatë vitit 2022 biznesi i sigurimeve të Jetës zuri 42.7% të tregut dhe ai i sigurimeve të Jo-Jetës zuri 57.3% të tregut.

Për sa i përket dëmeve, totali i dëmeve të paguara u rrit me 14.58% në krahasim me një vit më parë duke arritur në 805.46 miliardë HUF ose 2.01 miliardë euro. Dëmet e shkaktuara në segmentin e sigurimit të Jetës u rritën me 8.86% në vit duke arritur në 464.28 miliardë HUF. I njëjti tregues në sigurimin e Jo-Jetës arriti në 341.17 miliardë HUF arriti në total, një rritje prej 23.39% më shumë se një vit më parë.

Në fund të vitit 2022, numri i kontratave të shoqërive të sigurimit u rrit me 1.15% nga viti i kaluar. Kjo erdhi kryesisht nga një rritje prej 1.65% e numrit të kontratave të sigurimit të Jo-Jetës, shoqëruar nga një rënie e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës me - 1.51% më pak. Si rezultat, numri total i kontratave të sigurimit kaloi 14.81 milionë në fund të vitit 2022.

Në fund të vitit 2022, numri i shoqërive të sigurimit që i nënshtrohen Solvency II mbeti i pandryshuar, numri i institucioneve të mbikëqyrura ishte 22, nga këta 4 sigurues të Jetës, 9 sigurues të Jo-Jetës dhe 9 sigurues të përbërë.

Bazuar në vendbanimin e pronarëve të shoqërive të sigurimit, pronësia e huaj përbën 75% të tregut të sigurimit të Jetës dhe 100% për siguruesit e përbërë. Ndërsa për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës ky raport ishte 56%.

KROACI

www.xprimm.com

Duke iu referuar të dhënave nga Agjencia Kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare, HANFA, në dy muajt e parë të vitit 2023, 15 kompani sigurimesh që operojnë në tregun kroat, arkëtuan 258.3 milionë euro, nga të cilat 48.1 milionë euro (rreth 18.6%) u gjeneruan në tregun e sigurimit të Jetës dhe 210.1 milionë euro (rreth 81.4%) në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës.

Në strukturën e portofolit të tregut për sigurimet e Jo-Jetës, peshën më të madhe në vëllimin e primeve të shkruara bruto e zinte sigurimi i përgjegjësishë për mjete motorike, MTPL 35.1%, ndërsa sigurimet nga zjarri dhe dëmet natyrore zinin rreth 10% të vëllimit total të primeve.

Totali i dëmeve të paguara në dy muajt e parë të 2023 arriti në 172.2 milionë euro, që shpreh një rritje prej 10.7% në vit. Nga kjo shumë, 71.7 milionë euro janë paguar për sigurimet e Jetës, me rritje prej +10.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Për sigurimet e Jo-Jetës u paguan 100.5 milionë euro me rritje prej +10.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në totalin e dëmeve të paguara Jo-Jetës, shumat më të mëdha janë regjistruar në sigurimin e përgjegjësishë për automjetet (43.6%), sigurimin nga zjarri dhe dëmet natyrore (5.1%) dhe sigurimet e tjera të pasurisë (9.9%).

POLONI

www.xprimm.com

Sipas statistikave tremujore të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë KNF, tregu polak i sigurimeve gjatë vitit 2022 realizoi një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 72.35 miliardë PLN ose rreth 15.42 miliardë euro, duke u rritur me 4.53% krahasuar me një vit më parë. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara nga siguresit vendas u rritën me 7.46% krahasuar me vitin 2021 duke arritur në 44.38 miliardë PLN ose 9.46 miliardë euro.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ul me 2.64% krahasuar me 2021 duke arritur në 21.54 miliardë PLN ose 4.59 miliardë euro. Kjo rënie ishte kryesisht për shkak të rënies prej 29% të policave të sigurimit të Jetës të lidhura me skema të kursimit. Ndërsa segmenti i sigurimit të Jo-Jetës u rrit me 7.9% duke arritur në 50.81 miliardë PLN ose 10.83 miliardë euro.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas raportit të shifrave të tregut për vitin 2022, të publikuar nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros, IAC, siguruesit qipriotë raportuan një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 1.05 miliardë euro, me 9.5% më shumë se një vit më parë.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në segmentin e sigurimit të Jo-Jetës arriti në 533 milionë euro, duke shënuar një rritje me 4% krahasuar me vitin 2021. Ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës gjeneroi prime prej 520 milionë euro, ose 15.7% më shumë se vitin e kaluar.

Gjatë vitit 2022, vlera e dëmeve të paguara ishte 466.6 milionë euro duke shënuar rritje me 9% krahasuar me vitin 2021, nga të cilat 231.3 milionë euro lidheshin me sigurimin e Jetës, 130.5 milionë euro – sigurimi motorik, 66.4 milionë euro - aksidente dhe shëndetësi.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të fundvitit të Shoqatës Sllovene të Sigurimeve, tregu slloven i sigurimeve, në fund të vitit 2022, arriti në 2.79 miliardë euro, një rritje prej 7% nga viti i kaluar. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 3.12% krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 770 milionë euro. Ndërsa sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 8.5% krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 2.02 miliardë euro, duke zënë kështu 72.5% të primeve të shkruara bruto në total.

Vlera e përgjithshme e dëmeve të paguara, ishte 1.81 miliardë euro, nga të cilat rreth 511.12 milionë euro dëmshpërblime të Jetës, 626.6 milionë euro pagesa për kontratat e sigurimit shëndetësor, 413.6 milionë euro pagesa për klasa motorike (MTPL dhe sigurimi Kasko të përmbledhura) dhe rreth 150 milionë euro lidheshin me pretendime për sigurime të pronës.

TURQI

www.xprimm.com

Siç raporton “Reinsurance News”, Banka Turke e Sigurimit të Katastrofave (TCIP), deri tani ka paguar 340.36 milionë dollarë (6.5 miliardë TRY) dëme për viktimat në lidhje me tërmetet e fundit që ndodhën në Turqi muajin mars 2023. Sipas të dhënave të fundit, numri i ndërtesave të dëmtuara nga tërmetet arriti në 416.021.

Ofruesi i të dhënave të sigurimit të katastrofave PERILS publikoi së fundmi vlerësimin e tij të parë të humbjes së industrisë nga këta tërmete që arriti në nivelin e 3.5 miliardë dollarëve ose rreth 65.4 miliardë TRY. Dhe për sa i përket humbjeve të siguruara, sipas PERILS, humbja përfaqëson ngjarjen më të kushtueshme të katastrofës në historinë e regjistruar të Turqisë.

Vlerësimi i PERILS është nën vlerësimet e fundit nga Moody's RMS dhe CoreLogic, prej rreth 5 miliardë dollarë. Gjithashtu, firma globale e risigurimeve Hannover Re publikoi së fundmi vlerësime, duke vendosur humbjet e siguruara në 3.5-4 miliardë dollarë.



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al